

Ilmi Rexhepi

Duke lexuar revistën letrare "JETA E RE" me qëllimin kryesor që të marr vesh sa dhe si zbatohej atëherë standardi i shqipes dhe cili ishte përgjithësisht niveli gjuhësor; në numrat 4-5 të vitit 1976 që i kushtoheshin Hivzi Sulejmanit pas vdekjes së tij, gjeta dy artikuj të tij me tematikë gjuhësore, të sjellë aty:

1. Një kozeri e vogël me temë gjuhësore, dhe
2. Një fejtון me tematikë gjuhësore

Artikullin e parë e kishte botuar më parë "Rilindja" më 1952, kurse të dytin "Fjala" më 15.12.1972. Këto data i jepnin shënimet në fund të artikujve.

Më bënë përshtypje shumë, sepse shpesh, bazuar në njohuri të përgjithshme për orientimin politik të asaj kohe, biem në grackë të paragjykimeve dhe ndërtojmë mendime e bindje të pasakta pa e ndier nevojën e rivlerësimit shkencor dhe të mbështjetjes në prova.

Siç e thotë dhe i lumi Muhamed a.s."disa paragjykime përbëjnë xhynah(1)"

Demokracia kulturore, edhe për aq sa e kemi arritur, duhet të na edukojë që kontributin kulturor të brezave të mos e përjashtojmë për shkak të sistemeve politike, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri.

Kjo e para, kurse e dyta: M'u duk se më shumë atëherë i kushtohej rëndësi gjuhës shqipe seç i kushtohet sot. Në ato rrethana të pafavorshme për afirmimin e identitetit kombëtar, vërehet karakteri i përmbajtur, përpjekja për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, kurse sot, në liri të plotë, në Kosovë bëhet garë kush më shumë shkatërron njësinë kombëtare, identitetin shqiptar, sidomos elementin më qenësor të tij-gjuhën shqipe. Institucione të larta arsimore që kanë detyrë t'u mësojnë studentëve standardin e shqipes, në vend të kësaj, u mbjellin dyshime për drejtësinë e standardit të shqipes dhe me kaq i lënë, të paktën t'ua mësonin njëherë. Takon profesorë të rinj të Gjuhës shqipe që nuk arrijnë t'i shkruajnë drejt dy fjali, as në standard, as në gegërishte letrare, por janë në gjendje të të flasin me orë për padrejtësitë gjuhësore që qenkan bërë më 1972. Efekti kryesor-mbjellja e dyshimit.

T'u kthehem artikujve të Hivzi Sulejmanit!

Depërtimin e fjalës sllave në gjuhën shqipe që edhe sot përdorim: "unë veç kam ardhur, ajo makinë veç është shitur", në vend se "unë tashmë kam ardhur, ajo makinë tashmë është shitur"; Hivzi Sulejmani duket të ketë qenë i pari që e ka bërë objekt vështrimi kritik. Ai, në artikullin "Një fejtון me tematikë gjuhësore", shkruan:

"Kur jemi këtu, ta shohim edhe një fjalë kësisoj:

U ngriti çmimet e banesave që veç ishin shitur (Povisio je cene stanovima koji su ve? bili prodati)

Njëra veç ka dalë në Zagreb (Jedna je ve? izašla u Zagrebu)

E çka të bëjmë me ato të gjuhës shqipe siç janë: më, tanimë, tashmë? Mos janë dënuar ato me vdekje vallë?".

1. Standardi e jep me gj-gjynah, me kuptimi fetar besoj se duhet me xh-xhynah!